



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Numri i Aktit	01-02-2016
Titulli i Aktit	
Udhëzuesi	
Udhëzuesi i 2-të	
Udhëzuesi i 3-të	
Udhëzuesi i 4-të	
Udhëzuesi i 5-të	
Udhëzuesi i 6-të	
Udhëzuesi i 7-të	
Udhëzuesi i 8-të	
Udhëzuesi i 9-të	
Udhëzuesi i 10-të	

01-013/108



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.01.2016 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË PLANIT TË MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM PËR TERRITORIN E KOMUNËS SË VITISË

I.

Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALL shqyrtimin publik të Planit të mobilitetit të qëndrueshëm për rregullimin e Komunikacionit në territorin e Komunës së Vitisë.

II.

Të drejtë pjesëmarrje në shqyrtim publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë si dhe subjektet tjera të interesuara.

III.

Shqyrtimi publik duhet të shpallet së paku në tri gazeta të përditshme dhe në mjete të informimit dhe së paku 8 ditë para shqyrtimit publik

IV.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj (verbale dhe me shkrim) mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e shqyrtimit publik drejtpërdrejtë ose përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

V.

Hapja e shqyrtimit publik do të bëhet në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti nga data 11.02.2016 deri më datë 11.03.2016 për çdo ditë prej orës 8,00 - 16,00.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës së Vitisë dhe drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit,
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

